

William R. Hite, Jr., Ed.D.

Superintendent

13 Mars, 2020

Të dashur familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias po ju njofton sot se të gjitha shkollat do të mbyllen për një periudhë 2 - javore, duke filluar nga dita e Hënë 16 Mars, 2020 deri ditën e Premte 27 Mars, 2020.


Pavarësisht se Drejtoria Arsimore e Filadelfias nuk ka asnjë konformim të coronavirus në shkollat ose zyrat tona, mbyllja e shkollave shtë e domosdoshme sepse numri i personave me virus në zonat jashtë qytetit që banojnë shumë punonjës të drejtorisë arsimore po rritet dhe ata janë vetë - izolim. Asnjë nxënës nuk duhet të vijë në shkollë gjatë kësaj periudhe 2 javore. Gjatë kësaj kohe çdo shkollë do të pastrohet shumë mirë përpara së nxënësit dhe personeli të kthehen në shkollë. Informacione të mëtejshme do t'ju dërgohen familjarëve gjatë kësaj kohe për ti njoftuar për hapat e mëtejshme.

Gjatë kohës që implikimet dhe hollësitat për këtë mbyllje 2 javore po diskutohen, nxënësit inkurajohen të marrin në shtëpi materiale, gjëra personale, ilace dhe materiale të tjera që u duhen gjatë kohës së mbylljes së shkollës.

Ne e kuptojmë që vendimi për mbylljen e shkollave do të krijojë vështirësi për familjarët. Drejtoria Arsimore po punon bashkërisht me " Office of Emergency Management" dhe Departamentin Shëndetësor të Filadelfias të krijojnë një plan aktiv sa më të mundshëm për të plotësuar nevojat kritike të shërbimit për nxënësit dhe familjet e tyre. Ju lutem vizitoni: www.philasd.org për listën e shërbimeve të afuara nëpërmjet qytetit përfshirë ushqim dhe mundësi të tjera.

Për informacionet më të reja të kësaj situatë, ju lutem vizitoni: www.philasd.org/coronavirus. Ne do të vazhdojmë t'ju informojmë në lidhje me planin në progres. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj në këtë situatë të vështirë. Ju lutemi jini të sigurtë.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent
The School District of Philadelphia